# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2018 – Numri: 15

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E enjte, 8 shkurt 2018**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Dekret i Presidentit nr. 10718, datë 6.2.2018 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare | 617 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 56, datë 31.1.2018 | Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara | 617 |
| Kërkesë e Ministrisë së Brendshme nr. 3472/14, datë 6.2.2018 | Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugëve “Naftëtari”, “Kristaq Lacka” dhe “Qemal Stafa””, Bashkia Kuçovë | 618 |
| | Tabelat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 37, datë 24.1.2018, “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2018”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 9, datë 31 janar 2018 | 620 |

## DEKRET
## Nr. 10718, datë 6.2.2018

## PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme dhe ministrit të Turizmit dhe Mjedisit,

Dekretoj:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Amide Fari Darsi (Thaqi)
2. Ibish Nezir Hasani
3. Gasper Fran Nikollbibaj
4. Zoje Pjetër Nikollbibaj (Lazri)
5. Nitin Jayantilal Sandesara
6. Chetankumar Jayantilal Sandesara

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Ilir Meta**

## VENDIM
## Nr. 56, datë 31.1.2018

## PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE KONKRETE TË GRUPEVE TË PAFAVORIZUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 65/2016, "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërmarrjet sociale kontribuojnë në mbrojtjen sociale dhe mbështetjen e personave e të grupeve të pafavorizuara nëpërmjet punësimit dhe lehtësimit të aksesit në tregun e punës.

2. Grupet e personave të pafavorizuar kategorizohen në persona në kushte të pafavorshme:

a) përfituesit e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar në moshë aktive pune;

b) persona që nuk kanë ndjekur arsimin e detyrueshëm, të cilët janë të rrezikuar të përjashtohen nga tregu i punës dhe përballen me shumë vështirësi për sigurimin e një pune të qëndrueshme dhe që siguron të ardhura ose përfitime të mjaftueshme;

c) të vetëpunësuarit ose punëtorët e fermave familjare në bujqësi, të cilët janë të ekspozuar ndaj një pune të pasigurt e të paqëndrueshme, të cilët, në rast të dështimit të punës individuale apo në familje, rrezikohen të përballen me vështirësi të shumta në integrimin e tyre në tregun e punës;

ç) personat që jetojnë në zonat rurale që nuk kanë tokë, të cilët ndeshen me vështirësi të shumta në sigurimin e mjeteve të jetesës në mungesë të tokës dhe të aktivitetit bujqësor, pasi mundësitë që ofron tregu i punës për këto kategori janë shumë të kufizuara;

d) të papunët për një periudhë afatgjatë prej të paktën 12 muajsh;

dh) personat deri në 24 vjeç ose personat që kanë mbaruar studimet e arsimit të lartë prej jo më shumë se dy vjetësh dhe nuk kanë filluar një punë;

e) punonjësit migrantë që zhvendosen ose janë zhvendosur brenda vendit;

ë) personat që u përkasin pakicave kombëtare, të cilët kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën amtare dhe të përmirësojnë formimin e tyre profesional apo përvojën në punë, në mënyrë që të rrisin mundësitë për një punësim të qëndrueshëm;

f) çdo kryefamiljar që jeton vetëm ose është beqar, që ka në ngarkim të paktën një fëmijë;

g) persona që i përkasin moshës mbi 50 vjeç;

gj) çdo person që nuk ka përfituar një diplomë të arsimit të mesëm apo një diplomë ekuivalente më të, ose ka dy vjet, pas përfundimit të studimeve të arsimit të mesëm me kohë të plotë, që nuk ka një punë me pagesë të rregullt apo rrezikon ta humbasë atë;

h) personat që rezultojnë të varur apo ish-të varur nga droga, alkooli apo substanca të tjera psikotrope;

i) personat, të cilët nuk kanë pasur punën e tyre të parë të paguar rregullisht që nga fillimi i vuajtjes së dënimit me heqje lirie, me dënim alternativ apo çdo lloj dënimi tjetër penal;

j) gratë që jetojnë në zonat rurale:

i) ku niveli mesatar i papunësisë e kalon 50% të nivelit mesatar kombëtar për të paktën dy vjet kalendarikë;

ii) ku papunësia e gjinisë femërore është mbi 150% e nivelit mesatar të papunësisë së gjinisë mashkullore për të paktën dy nga tre vjetët e fundit kalendarikë;

k) gratë dhe vajzat viktima/viktima të mundshme të trafikimit, të shfrytëzimit dhe të dhunës në familje;

l) personat me aftësi të kufizuar;

ll) refugjatët, sipas përcaktimit të ligjit për azilin;

m) azilkërkuesit;

n) personat me mbrojtje plotësuese;

nj) personat me mbrojtje të përkohshme;

o) anëtarët e familjes së refugjatit;

p) anëtarët e familjes së personit që i është njohur statusi i mbrojtjes plotësuese;

q) personat pa shtetësi;

r) personat e pastrehë;

rr) ish-të burgosurit;

s) personat me identitet të ndryshëm gjinor dhe orientim të ndryshëm seksual.

3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**KËRKESË**
**Nr. 3472/14, datë 6.2.2018**

**PËR SHPRONËSIM**

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i rrugëve "Naftëtari", "Kristaq Lacka" dhe "Qemal Stafa"", Bashkia Kuçovë.

Subjekti kërkues është Bashkia Kuçovë. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është: 7 117 110 (shtatë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e dhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM
**Romina Kuko**

**LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I RRUGËVE “NAFTËTARI”, “KRISTAQ LACKA” DHE “QEMAL STAFA””, BASHKIA KUÇOVË**

| Nr. | Emri Mbiemri (Pronari që shpronësohet) | Nr. i pasurisë | Z K | Sip. truall/m² | Çmimi i truallit lekë/m² | Vlera e truallit lekë | Sip. ndërtimi m² | Çmimi i ndërtesës lekë/m² | Vlera e ndërtesës lekë | Vlera totale | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pëllumb Sina | 11/668 | 2310 | 44 | 2,040 | 89760.0 | 59.61 | 32,317.00 | 1,618,190.00 | 1,707,950.0 | Konfirmim ZVRPP |
| 2 | Murat Benja | 6/314 | 2310 | 87 | 2,040 | 177480.0 | 126 | 32,317.00 | 1,993,623.00 | 2,171,103.0 | Konfirmim ZVRPP |
| 3 | Celnik Braho | 9/447 | 2310 | 48 | 2,040 | 97920.0 | 92 | 32,317.00 | 2,348,800.00 | 2,446,720.0 | Konfirmim ZVRPP |
| 4 | Përparim Shkurti | **11/53,11/577** | 2310 | 6 | 2,040 | 12240.0 | 2 | 32,317.00 | 49,768.00 | 62,008.0 | Konfirmim ZVRPP |
| 5 | Luljaeta Brahimi | 1046/15 | 2918 | 67(tokë arë) | 311 | 20,837.0 | | | | 20,837.0 | Konfirmim ZVRPP |
| 6 | Dhimitër Bullari | 9,/6 | 2310 | 228 | 2,040 | 465,120.0 | | | | 465,120.0 | Konfirmim ZVRPP |
| 7 | Sotiraq Bitri | 11/235 | 2310 | 17 | 2,040 | 34,680.0 | | | | 34,680.0 | Konfirmim ZVRPP |
| 8 | Arjan Qato | 6/196 | 2310 | 21 | 2,040 | 42,840.0 | | | | 42,840.0 | Konfirmim ZVRPP |
| 9 | Mihal Celaj | 9,/7 | 2310 | 24 | 2,040 | 48,960.0 | | | | 48,960.0 | Konfirmim ZVRPP |
| 10 | QPN Kuçovë | 9/462 | 2310 | 50 | 2,040 | 102,000.0 | | | | 102,000.0 | Konfirmim ZVRPP |
| 11 | Vangjel Pjetri | 6/197 | 2310 | 7.3 | 2,040 | 14,892.0 | | | | 14,892.0 | Konfirmim ZVRPP |
| | **Shuma që shpronësohet** | | | | | | | | | **7,117,110.0** | |

Tabelat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 37, datë 24.1.2018, "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2018"

**Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2018**
**MINISTRIA E MBROJTJES**

| Nr. | Titulli i projektaktit | Ministri propozues dhe bashkëpropozues | Katërmujori | Arsyeja e nxjerrjes së projektaktit | Qëllimi i projektaktit | Objektivat që kërkon të realizojë projektakti | Çështjet që rregullon projektakti | Lidhja me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian | Lidhja me programin qeverisë 2017-2021 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Projektligj "Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut" | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Kërkesë e dalë nga praktika | Qëllimi i projektaktit është të përmirësojë praktikën e deritanishme në njohjen dhe dhënien e statusit të ushtarakut | Është përmirësimi i legjislacionin në fuqi për statusin e dëshmorit të atdheut | Akti parashikon të rregullojë procedurën e shpalljes dhe njohjes së statusit të dëshmorit | Jo | Jo |
| 2 | Projektligj "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë" | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | Kërkesë e dalë nga praktika | Qëllimi i këtij projekt ligji është vendosja e kontrollit shtetëror mbi transferimin ndërkombëtar të mallrave të ushtarake, artikujve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, për të siguruar mbrojtjen e interesave kombëtare të Republikës së Shqipërisë, sigurinë dhe politikën e jashtme, kredibilitetitin ndërkombëtar të saj, dhe garantimin e respektimit të angazhimeve ndërkombëtare të | Ky projektligj synon përafrimin e pjesshëm të rregullores së Këshillit të Evropës (KE) nr. 428/2009, "Për vendosjen e një regjimi komunitar për kontrollin e eksportit, transferimit, ndërmjetësimit dhe tranzitit të sistemeve me përdorim të dyfishtë" dhe është hartuar | Akti rregullon procedurën e kontrollit shtetëror mbi mallrat ushtarake dhe artikujt e ndryshëm teknologjikë me përdorim të dyfishtë | Rregullore e Këshillit të Evropës (KE) nr. 428/2009 | Jo |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Republikës së Shqipërisë në këtë fushë. | | | | |
| 3 | Projektvendim "Për trajtimin dhe mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit ushtarak dhe civil të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjatë kohës që emërohen me shërbim jashtë vendit" | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | Detyrim ligjor | Ky projektvendim synon formalizimin e procedurës se ofrimit të shërbimit të kujdestarisë, nga familje kujdestare të përgatitura për të marrë fëmijë pa kujdes prindëror në kujdestari. | Projektvendimi do të rregullojë procedurat e menaxhimit të fondeve buxhetore, të cilat janë vënë në dispozicion të personelit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të emëruar jashtë vendit. Nëpërmjet këtij projektakti synohet të rregullohen modalitetet e trajtimit financiar të ushtarakëve shqiptarë dhe punonjësit civilë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, vetëm në rastet kur në strukturë parashikohet përfaqësimi i barasvlershëm me gradat e personelit ushtarak, që emërohen dhe ushtrojnë detyrën si rezident në një shtet të huaj. | Akti rregullon procedurën e përfitimit financiar të ushtarakëve kur emërohen me shërbim jashtë shtetit | Jo | Jo |
| 4 | Projektvendim për përcaktimin e stemës dhe flamurit të AISM" | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | Detyrim ligjor | Ky projektvendim synon përcaktimin e stemës dhe flamurit te AISM-s | Synon krijimin e bazës ligjore për formalizimin e stemës dhe flamurit që përdor AISM-ja | Akti përcakton stemën dhe flamurin e AISM | Jo | Jo |
| 5 | Projektvendim "Për përcaktimin e kritereve dhe masës së përfitimit të kompensimit për shkak të humbjes së jetës në detyrë të punonjësit civil të AISM" | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | Detyrim ligjor | Ky projektvendim synon dhënien e shpërblimeve financiare për të rënët apo sëmundjet e punonjësve të AISM-s | Objektivi i aktit është vendosja e përfitimeve materiale në rastet e humbjes së jetës | Përcaktimi i kritereve dhe masës së përfitimit të kompensimit për shkak të humbjes së jetës në detyrë të punonjësit civil të AISM" | Jo | Jo |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr. 475, datë 8.6.2017, "Për pjesëmarrjen e një toge të FARSH në Operacionin Ushtarak të NATO-S në Letoni" | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | Detyrim ligjor ngas marrëveshja përkatëse | Ky akt synon pjesëmarrjen e togës përkatëse në misionin ushtarak | Objekti i aktit është sigurimi i bazës ligjore për dërgimin e një toge ushtarakësh në Letoni | Dërgimi i një toge të Forcave të Armatosura me mision në Operacionin Ushtarak të NATO-S në Letoni" | Jo | Jo |
| 7 | Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të FARSH" | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | detyrim i ardhur nga praktika | Qëllimi i këtij akti është përmirësimi i statusit të ushtarakut | Objektivi është krijimi i bazës ligjore të aftë për të rregulluar problematikat e dala nga zbatimi i ligjit në praktikë me situatat konkrete | Te drejtat dhe detyrimet që lindin për ushtarakun në momentin e fitimit të statusit si ushtarak i forcave të Armatosura të RSH-së. | Jo | Jo |
| 8 | Projektvendim "Për shpronësim për interes publik të sipërfaqes që preket nga ndërtimi i vendprehjes së ushtareve grekë të rënë në vitet 1939-1942" | Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë | Katërmujori I | Detyrim ligjor që rrjedh nga marrëveshja e nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Greqisë | Qëllimi i këtij akti është përgatitja e bazës ligjore për vënien në dispozicion të procesit të ndërtimit të vendprehjes të sipërfaqes tokësore | Objektivi është vënia në dispozicion truallit përkatës për ndërtimin e vendprehjes | Shpronësimin për interes publik të sipërfaqes që preket nga ndërtimi i vendprehjes së ushtareve grekë të rënë në vitet 1939-1942. | Jo | Jo |
| 9 | Projektvendim "Për përcaktimin e kritereve të gradimit të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve në rezervë" | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | detyrim ligjor | Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë kriteret e gradimit për ushtarakët e shërbimit në rezervë si një kategori i veçantë e shërbimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë | Objektivi i aktit është përcaktimi i kritereve për caktimin e gradave | Përcaktimi i kritereve të gradimit të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve në rezervë. | Jo | Jo |
| 10 | Projektvendim "Për pjesëmarrjen e FARSH ne Operacionin "RSM" te NATO-s ne Afganistan me një personel prej 36 ushtarakesh ne Kabul" | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | Detyrim ligjor qe rrjedh nga marrëveshjet ku Shqipëria është pale | Ky vendim ka për qellim krijimin e bazës ligjore pjesëmarrjen e FARSH-s ne Operacion | Objektivi është realizimi i detyrimit për te marre pjese ne mision | Dërgimi i një kontingjenti te Forcave te Armatosura me mision ne Operacionin "RSM" te NATO-s ne Kabul, Afganistan | Jo | Jo |
| 11 | Projektvendim "Për pjesëmarrjen e FARSH ne Operacionin "RSM" te NATO-s ne Kabul, Afganistan. | Ministri i Mbrojtjes | Katër mujori II | Detyrim ligjor qe rrjedh nga | Ky vendim ka për qellim krijimin e bazës ligjore | Objektivi është realizimi i detyrimit për te marre pjese ne mision | Dërgimi i një kontingjenti te Forcave te Armatosura me | Jo | Jo |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | marrëveshjet ku Shqipëria është pale | pjesëmarrjen e FARSH-s ne Operacion | | mision ne Operacionin "RSM" te NATO-s ne Kabul, Afganistan | | |
| 12 | Projektvendim "Për pjesëmarrjen e FARSH ne Operacionin "RSM" te NATO-s ne Shtabin e TAAC-WEST, ne Herat, Afganistan. | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | Detyrim ligjor qe rrjedh nga marrëveshjet ku Shqipëria është pale | Ky vendim ka për qellim krijimin e bazës ligjore pjesëmarrjen e FARSH-s ne Operacion | Objektivi është realizimi i detyrimit për te marre pjese ne mision | Dërgimi i një kontingjenti te Forcave te Armatosura me mision ne Operacionin "RSM" te NATO-s ne Shtabin e TAAC-WEST, ne Herat, Afganistan. | Jo | Jo |
| 13 | Projektvendim "Për një ndryshim ne vendimin nr. 400, date 1.6.2016, "Për pjesëmarrjen e FARSH ne Operacionin Ushtarak te Bashkimit Europian me mision trajnues, ne Republikën e Malit, ne Afrike" | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | Detyrim ligjor qe rrjedh nga marrëveshjet ku Shqipëria është pale | Qëllimi është zgjatja me dy vite e misionit. | Objektivi është realizimi i detyrimit për te marre pjese ne mision | Ndryshimi i vendimit nr. 400, date 01.06.2016 "Për pjesëmarrjen e FARSH ne Operacionin Ushtarak te Bashkimit Europian me mision trajnues, ne Republikën e Malit, ne Afrike, duke e zgjatur misionin dhe me dy vite te tjera. | Jo | Jo |
| 14 | Projektvendim "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave të Bosnjë dhe Hercegovinës, Qeverisë së Malit të Zi, Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë në lidhje me masat e vendit pritës mbi statusin strukturës organizuese dhe personelit të saj". | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | Detyrim ligjor qe rrjedh nga marrëveshjet ku Shqipëria është pale | Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është te përcaktojë statusin e strukturës organizuese te Task-Forcës Mjekësore te Ballkanit dhe qe struktura organizuese e kësaj Task-Force te kryeje detyrat dhe funksionet ne mënyre efikase nëpërmjet drejtimit operacional. | Objektivi i këtij akti është krijimi i bazës ligjore për krijimin e Taks-Forcës Mjekësore | Përcaktimi i statusit te strukturës organizuese te Task-Forcës Mjekësore te Ballkanit. | Jo | Jo |
| 15 | Projektvendim "Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë, Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin dhe Shtabit Suprem të | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | Detyrim ligjor qe rrjedh nga marrëveshjet ku Shqipëria | Qëllimi i këtij projektvendimi është krijimi i bazës ligjore për pranimin dhe dhënien e | Objektivi i këtij akti zbatimi i detyrimit ligjor qe rrjedh nga marrëveshja përkatëse ku Shqipëria është pale | Krijimi i bazës ligjore për pranimin dhe dhënien e mbështetjes se shtetit pritës ne rastet e stërvitjeve apo | Jo | Jo |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Fuqive Aleate në Evropë në lidhje me dhënien e mbështetjes së shtetit pritës për ekzekutimin e operacioneve/stërvitjeve dhe aktiviteteve ushtarake të ngjashme të NATO-s dhe Notës së Pranimit për t'u bërë pjesë e tij" | | | është pale | mbështetjes se shtetit pritës ne rastet e stërvitjeve apo operacioneve te përbashkëta | | operacioneve te përbashkëta. | | |
| 16 | Projektvendim "Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Finlandës, Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë në lidhje me dhënien e mbështetjes së shtetit pritës për ekzekutimin e operacioneve/stërvitjeve dhe aktiviteteve ushtarake të ngjashme të NATO-s dhe Notës së Pranimit për t'u bërë pjesë e tij" | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | Detyrim ligjor | Qëllimi i këtij projektvendimi është krijimi i bazës ligjore për pranimin dhe dhënien e mbështetjes se shtetit pritës ne rastet e stërvitjeve apo operacioneve te përbashkëta | Objektivi i këtij akti zbatimi i detyrimit ligjor qe rrjedh nga marrëveshja përkatëse ku Shqipëria është pale | Krijimi i bazës ligjore për pranimin dhe dhënien e mbështetjes se shtetit pritës ne rastet e stërvitjeve apo operacioneve te përbashkëta. | Jo | Jo |

**Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2018**
**Ministria e Kulturës**

| Nr. | Titulli i projektaktit | Ministri propozues dhe bashkëpropozues | Katërmujori | Arsyeja e nxjerrjes së projektaktit | Qëllimi i projektaktit | Objektivat që kërkon të realizojë projektakti | Çështjet që rregullon projektakti | Lidhja me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian | Lidhja me programin qeverisës 2017-2021 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Projektligj-Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 10352 date 18.11.2010 "Për artin dhe Kulturën" | Ministri i Kulturës | Katërmujori I | 1. Përmirësimi i kuadrit ligjor ne funksion te mirëmenaxhimit te sistemit kulturor institucional e me gjere. Synojmë rritjen graduale e ne mënyrë te ndjeshme te cilësisë produktit artistik, impaktit artistik, ne vend dhe me gjere. Synojmë gjithpërfshirjen e grupeve te interesit ne projektet artistike dhe veprimtarive me fokus art kulture. 4. Riorganizimi i institucioneve te artit dhe kulturës | 1. Përmirësimi i kuadrit ligjoj ne funksion te mirëmenaxhimit te sistemit kulturor institucional e me gjere. 2. Synojmë rritjen graduale e ne mënyrë te ndjeshme te cilësisë produktit artistik, impaktit artistik,ne vend dhe me gjere. 3. Synojmë gjithpërfshirjen e grupeve te interesit ne projektet artistike dhe veprimtarive me fokus art kulture. 4. Riorganizimi i institucioneve te artit dhe kulturës | Synon te forcoje, përmirësojë, funksionimin realizimin dhe financimin e artit dhe kulturës ne vend dhe bashkëpunimin nderinstitucional si dhe te drejtat dhe detyrimet e subjekteve qe kane për objekt artin dhe kulturën. 2. synon te realizoje konsolidimin dhe eficenze nga grupet e interesit ne lidhje me njohuritë dhe zbatueshmërinë ligjore me qellim rritjen me 50% cilësisht te produktit dhe impaktit artistik brenda dhe jashtë vendit brenda 5 vjetësh nga dita e hyrjes ne fuqi te tij | 1. Parashikohet te përmirësohet parashikimi për strategjinë, dhe politikat për ministrinë përgjegjëse për kulturën. Projektakti ka nevoje për përmirësim te procedurave, lidhur me funksionimin e bordeve qe funksionojnë pranë institucioneve te artit dhe kulturës, si dhe lehtësim te procedurave për emërimin e drejtoreve te institucioneve qendrore te artit dhe kulturës. Është e nevojshme ndërhyrja për ndryshim pas problematikave të hasura nga mos implementimi i dispozitave të ligjit gjë që ka sjellë ankesa nga grupet e interesit si dhe nga organet e pushtetit vendor të cilët kanë hasur vështirësi në procedurat e realizimit te projekteve artistike të cilat është e pamundur ti | JO | Jo |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | nënshtrohen ligjit "Për prokurimin publik". | | |
| 2 | Projektvendim - Për Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e integruar BSH/DATANLA te Bibliotekës Kombëtare te Shqipërisë | Ministri i Kulturës | Katërmujori I | Detyrim ligjor | Projektakti synon krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e integruar bibliotekar DATAbksh/DATAnla të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. | Projektakti ka për objektiv krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e integruar bibliotekar dataBKSH / dataNLA të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë si dhe përcaktimin e funksionimit, organizimit se bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e integruar bibliotekar DATAbksh/DATAnla të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. | Në projektvendim parashikohet te krijimi i bazës te dhënave shtetërore për sistemin e integruar bibliotekar dataBKSH e cila do te përmbajë a) Të dhënat e përshkrimit bibliografik. Po kështu ne projektvendim parashikohet te rregullohet institucioni administrues i këtyre te dhënave, ndarja e te dhënave ne parësore dhe dytësore. Ky projektakt do te parashikoje format e shkëmbimit te informacionit te te dhënave shtetërore si dhe ndarjen e tyre si subjekte te interesuara dhe përdorues te këtyre te dhënave. | JO | Jo |
| 3 | Projektvendim -Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin ëebgiz për menaxhimin e e veprimtarisë arkeologjike ne terren të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik. | Ministri i Kulturës | Katërmujori I | Detyrim ligjor | Projektakti ka për synim krijimin e bazës së të dhënave për ruajtjen dhe manaxhimin e të gjithë informacionit gjeohapësinor të aktivitetit të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik që nga krijimi e në vijim; administrimin dhe ndërveprimin ndërmjet tyre, për të siguruar përdorimin me efektivitet, për interesa | Objektivi kryesor është krijimi i Sistemit te bazës së të dhënave shtetërore e cila do te garantojë transparencë në procesin administrativ, do të ofrojë informacion dhe shërbime elektronike si dhe ndërveprime midis tyre. | Projektakti do te përcaktoje te dhënat shtetërore qe do te përmbajë sistemi ëebgiz, te dhënat qe do te përmbaje "Databazës Gjeografike për Regjistrimin e Aktivitetit në Terren", klasifikimin e tyre, nivelet e perdoruesve te sistemit, gjitha ndryshimet në arkitekturën software dhe hardware të SëMVAT-it të Agjencisë së Shërbimit | JO | Jo |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | dhe shërbime publike | | Arkeologjik. | | |
| 4 | Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore (RKPK)" të Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore | Ministri i Kulturës | Katërmujori I | Detyrim ligjor | Projektvendimi ka për qëllim krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për për sistemin e ëebgiz për menaxhimin e veprimtarisë arkeologjike në terren të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik. | Krijimi i një Sistemi informatik kombëtar të Administrimit të Trashëgimisë Kulturore ëeb dhe i një database unike për trashëgiminë kulturore, me qëllim identifikimin, katalogimin, ruajtjen dhe përdorimin e saj duhet të realizohet sipas të gjitha standardeve dhe rekomandimeve ndërkombëtare ku të theksohet aksesi i publikut dhe i institucioneve të interesit për përdorimin të lirë. | Projektakti parashikon çështje qe lidhen me krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore RKPK, institucionin administrues i bazës së të dhënave shtetërore për Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore, ndarjen e te dhënave ne parësore dhe dytësore, ndarja e subjekteve qe do te jene ne cilësinë e dhënësit te informacionit etj. | JO | Jo |
| 5 | Projektvendim -Për krijimin e Qendrës Kombëtare te Librit dhe Leximit QKLL | Ministri i Kulturës | Katër mujori I | Projektakti është parashikuar ne programin e qeverise | Projektakti ka për qellim krijimin e Qendrës Kombëtare te Librit dhe Leximit | Krijimi i një institucioni shtetëror qendror ne varesi te Ministrisë se Kulturës e cila do te zhvilloje politikat ne fushën e librit dhe leximit duke mbështetur projekte te skenës se pavarur ne fushën e librit dhe leximit si dhe ndërmarrjen e projekteve me iniciative te saj me qellim rritjen e ndërgjegjësimit per rëndësinë e librit dhe leximit ne shoqëri. | Ky projektakt parashikon funksionimin, kompetencat përbërjen e QKLL | JO | Jo |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Projektvendim -Për shumat e shpërblimit nga riprodhimi i veprave për përdorim privat dhe vetjak ose për përdorim tjetër personal | Ministri i Kulturës | Katër mujori I | Detyrim ligjor | Projektvendimi ka për qellim zbatimin e te nenit 31, te ligjit 35/2016, "Për te drejtën e autorit" duke miratuar tarifat për riprodhimi i veprave për përdorim privat dhe vetjak ose për përdorim tjetër personal" | Objekti është përcaktimi i tarifave te shpërblimit nga riprodhimi i veprave për përdorim privat/ vetjak ose për përdorim tjetër personal. | Projektakti do te rregulloje çështje qe kane te bëjnë me përcaktimin e listës së pajisjeve dhe tarifave për shpërblim të arsyeshëm nga shitja e parë ose importi i pajisjeve/aparateve/ makinerive/materialeve në Republikën e Shqipërisë, të cilat bëjnë të mundur riprodhimin e veprave nëpërmjet fotokopjes, regjistrimit të zërit, videos/figurës, tekstit ose nëpërmjet çdo forme tjetër, për përdorim privat dhe vetjak ose për përdorim tjetër personal. | JO | Jo |
| 7 | Projektvendim -Për shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Tragjas i Vjetër dhe miratimin e rregullores së administrimin e tij | Ministri i Kultures | Katërmujori II | Detyrim ligjor | Projektvendimi ka për qëllim shpalljen e Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të fshatit Tragjas i Vjetër si dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen; ruajtjen, promovimin dhe administrimin e Tragjasit | Objekti i këtij vendimi është hulumtimi; mbrojtja; ruajtja; promovimi dhe administrimi i vendbanimeve tradicionale shqiptare, ne këtë rast fshati Tragjas i Vjetër. | Rregullore e administrimit të ansamblit arkitektonik Tragjasi i Vjetër, Vlorë | JO | Jo |
| 8 | Për miratimin e Strategjisë Kombëtare te Kulturës 2017-2022 | Ministri i Kultures | Katërmujori II | Projektakti është parashikuar në PKIE | Përmirësimi dhe zgjerimi I tregut kulturor nëpërmjet një legjislacioni në dobi të krijuesve, krijimtarisë artistike kulturore dhe trashëgimisë kulturore 2) ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo | Miratimi i strategjisë së kulturës 2017-2022 dhe plani I veprimit funksional | Strategjia e Kulturës 2017-2022 dhe plani I veprimit funksional | PO/Kapitulli 26 Arsimi dhe Kultura/ Kuadri i Planifikuar i Politikave 2015-2017 | Pika 2.6 Turizmi dhe Kultura |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | materiale 3) mbështetja e krijimtarisë dhe aktiviteteve krijuese te artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve | | | | |
| 9 | Projektligj-Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9616 date 27.09.2006 "Për Librin ne Republikën e Shqipërisë" | Ministri i Kultures | Katërmujori III | Propozimi dhe përmbushja e detyrave profesionale, zhvillimore dhe ekzekutive që lidhen me zbatimin e dokumenteve strategjike dhe politikave në fushën e librit | Një nga qëllimet kryesore te projektligjit është Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit e cila është propozimi dhe përmbushja e detyrave profesionale, zhvillimore dhe ekzekutive që lidhen me zbatimin e dokumenteve strategjike dhe politikave në fushën e librit. QKLL kryen çdo detyrë tjetër që lidhen me promovimin, nxitjen dhe zhvillimin e politikave në fushën e librit. QKLL siguron kushtet për rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e librit dhe leximit në zhvillimin e individit dhe shoqërisë, brenda dhe jashtë vendit. | Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e librit dhe leximit në zhvillimin e individit dhe shoqërisë, brenda dhe jashtë vendit. | Në këtë projektigj përcaktohen rregullat e organizimit, të funksionimit, realizimit dhe financimit të projekteve dhe programeve të librit, si dhe të drejtat e detyrimet e subjekteve që kanë për objekt veprimtarie librin dhe produkte të përafërta me librin, të cilat janë palë në zbatimin e tyre. | PO. Kapitulli 26 Arsimi dhe kultura nënndarja "Prioritetet | Pika 2.6 Turizmi dhe Kultura |
| 10 | Projektvendim -Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimit te anëtarëve te organeve kolegjiale ne fushën e trashëgimisë kulturore | Ministri i Kulturës | Katërmujori III | Detyrim ligjor | Nje nga qellimet kryesore eshte venia ne zbatim e nenit 37 te projektligjit te Trashegimise kulturore i cili ngarkon KM per te miratuar vendimin per | Objekti është përcaktimi i përbërjes, mënyra e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimi i organeve kolegjiale vendimmarrëse ne | Ne këtë projektvendim synohet te arrihet riorganizimi i ri i organeve kolegjiale te TK ne përshtatje me ligjin e ri, duke i dhënë kompetenca te reja sipas | JO | Jo |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | perberjen, menyren e funksionimit, kompetencat dhe shperblimin e antareve te organeve kolegjiale ne fushen e TK perkateshisht: KKTKM; KKTKJM; KMPKM, KKM | fushën e trashëgimisë kulturore. | këtij organizimi si dhe përcaktimi per shpërblimin e anëtarëve ne përbërje te tyre. | | |
| 11 | Projektvendim -Për procedurat e konkurrimit publik ne rastet e kryerjes se investimeve me fonde publike ne trashegimine kulturore | Ministri i Kulturës | Katër mujori III | Detyrim ligjor | Ne kete projektvendim parashikohet te percaktohet se ne rastet e kryerjes se investimeve me fonde publike ne fushen e trashegimise kulturore, procedurat e perzgjedhjes se subjekteve te pajisura me licencat ne fushen e TK behet ne baze te rregullave specifike. | Objekti është përcaktimi i procedurave te konkurrimit publik per kryerjen e investimeve me fonde publike ne objektet e trashëgimisë kulturore. | Çështjet qe synohen te rregullohen do kene te bejne me parashikime rregulla procedura, konkurrime publike per perzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje apo kolaudim në pasuritë kulturore, te cilet do të përjashtohen nga zbatimi i parashikimeve të ligjit mbi prokurimin. | JO | Jo |
| 12 | Projektvendim -Per percaktimin e procedurave per hulumtimet arkeologjike | Ministri i Kulturës | Katërmujori III | Detyrim ligjor | Percaktimi i procedurave procedurave qe do te ndiqen ne rast hulumtimesh arkeologjike | Percaktimi i humultimeve arkelogjike ne te gjithe territorin e Repubikes se Shqiperise. Percaktimi I rregullave te detajuara, nga institucione te specializuara, pas propozimit te bere nga IKTK-se. Evidentimi i pasurisë arkeologjike përmes hulumtimeve në tokë dhe nënujë kryhet me teknika shkencore jo shkatërruese | Hulumtimet arkeologjike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë ekskluzivitet i institucioneve të specializuara të trashëgimisë kulturore ose subjekteve të licencuara sipas këtij ligji, në përputhje me rregullat që hartohen nga institucionet e specializuara shtetërore. Procedura për hulumtimet arkeologjike parashikohet te rregullohet me Vendim të Këshillit të Ministrave | JO | Jo |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | dhe propozim të IKTK-së. | | |
| 13 | Projektvendim -Për strukturën, mënyrën e organizmit dhe të funksionimit në zyrën dhe degët territoriale të Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore | Ministri i Kulturës | Katërmujori III | Detyrim ligjor | Krijohet Inspektorati Kombëtar Përgjegjës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore (në vijim IKMTK-ja), si institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore | percaktimi i kompetencave dhe çdo funksioni tjeter sipas ligjit te TK | ky projektvendim do te percaktoje ne menyre te detajuar menyren e funksionimit te IKMT-se e cila do ti nenshtrohet dispozitave te kodit te punes dhe ligjit per inspektimin ne Republikes se Shqiperise | JO | Jo |
| 14 | Projektvendim -Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar te Trashëgimisë Kulturore | Ministri i Kulturës | Katërmujori III | Detyrim ligjor | Krijohet Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore i cili ushtron veprimtarinë e tij në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, me qëllim gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale | percaktimi i kompetencave dhe çdo funksioni tjeter sipas ligjit te TK | ky projektvendim do te percaktoje ne menyre te detajuar menyren e funksionimit te IKTK-se bazuar ne ligjin e TK-se | JO | Jo |
